VENDIM
Nr.355, datë 12.5.2010

PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMEVE, TË CIKLIT TË PARË, "INXHINIERI EKONOMIKE", NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 26 dhe 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Hapjen, në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike të Universitetit Politeknik të Tiranës, të programit të studimeve të ciklit të parë "Inxhinieri ekonomike". Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet "Diplomë e nivelit të parë, DNP, në inxhinieri ekonomike".

2.Programi i studimeve të ciklit të parë realizohet me 180 kredite, ECTS, dhe kohëzgjatja normale e tij është 3 (tre) vite akademike.

3.Programi i studimeve "Inxhinieri ekonomike" fillon veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2010-2011.

4.Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Universitetit Politeknik të Tiranës, pa efekte buxhetore shtesë.

5.Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Universiteti Politeknik i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha